çift të vetëm elektronesh tek atomi drejtpërsëdrejti të bashkuar me unazën e fenilit e treguar në formulën (E-1B) , ku ky zëvendësues preferueshëm është përzgjedhur nga -OH dhe -NH2, dhe i cili akoma më preferueshëm është -NH2, dhe ku lidhja ndërmjet R5B dhe unaza fenil tregon se grupi s R5B zëvendëson atomet hidrogjen s në secilin pozicion të unazës së fenilit; R6A është në mënyrë të pavarur për secilën shfaqje për t > 1, një zëvendësues që tërheq elektrone, i cili preferueshëm është përzgjedhur nga -NO2 dhe -COOH, dhe i cili akoma më preferueshëm është -COOH, dhe ku lidhja ndërmjet R6A dhe unazës fenil tregon se grupet t R6A zëvendësojnë atomet hidrogjen t në secilin pozicion të unazës fenil; dhe
R6B është, në mënyrë të pavarur për secilën shfaqje për t > 1, një zëvendësues që bart një çift të vetëm elektronesh tek atomi drejtpërsëdrejti të bashkuar tek unaza e fenilit të treguar në formulën (E-1B) , ku ky zëvendësues preferueshëm është përzgjedhur nga -OH dhe -NH2, dhe i cili akoma më preferueshëm është -OH, dhe ku lidhja ndërmjet R6B dhe unazës fenil tregon se grupet t R6B zëvendësojnë atomet hidrogjen t në secilin pozicion në unazën fenil; dhe

b) një bartës, eksipient dhe/ose tretës farmaceutikisht i pranueshëm.
2. Përbërja farmaceutike e pretendimit 1, ku m është 2, n është 2 ose 4, R1L- është NH, R2L është C, dhe R3L është NH.
3. Përbërja farmaceutike e pretendimit 1 ose 2, ku L1 është një grup bashkues divalent me një strukturë të përzgjedhur nga një oligoamid i cili përmban një total prej 1 deri në 5, akoma më preferueshëm një total prej 1 deri në 3, dhe akoma më preferueshëm një total prej 1 deri në 2 lidhje amide brenda skeletit të tij, dhe një oligo(ester-amid) i cili përmban një total prej 2 deri në 5, më preferueshëm një total prej 2 deri në 3, dhe akoma më preferueshëm një total prej 2 amidesh dhe lidhje esterike brenda skeletit të tij, ku grupi bashkues mund të bartë një grup EDS.
4. Përbërja farmaceutike e secilit prej pretendimeve 1 deri në 3, ku grupi funksional -X2-L1-X1- në formulën (I) ka një strukturë të përzgjedhur nga: *-C(O) -NH-R7-NH-C(O) -R8-C(O) -NH- (L-1) , *-C(O) -NH-R9A-NH-C(O) -R10A-C(O) -NH-R11A-NH-C(O) - (L-2A) , dhe *-C(O) -NH-R9B-C(O) -NH-R10B-C(O) -NH-R11B-NH-C(O) - (L-2B) ; ku lidhja amide e shenjuar me * është bashkuar tek atomi i karbonit që mbart R2 në formulën (I) , dhe ku R7, R8, R9A, R9B, R11A dhe R11B janë përzgjedhur në mënyrë të pavarur nga C2 deri në C10 alkandiil opsionalisht i zëvendësuar, ku grupet alkandiil mund të zëvendësohen secili nga një ose më shumë zëvendësues të përzgjedhur në mënyrë të pavarur nga -OH, -OCH3, -COOH, -COOCH3, -NH2, -NHC(NH) NH2, dhe një grup EDS, dhe R10A dhe R10B janë përzgjedhur nga C2 deri në C10 alkandiil op-sionalisht i zëvendësuar, dhe arendiil C6 deri në C10 opsionalisht i zëvendësuar, ku grupi alkandiil dhe arendiil mund të zëvendësohen secili me një ose më shumë zëvendësues të përzgjedhur në mënyrë të pavarur nga -OH, -OCH3, -COOH, -COOCH3, -NH2, -NHC(NH) NH2, dhe një grup EDS.
5. Përbërja farmaceutike e pretendimit 4, ku gtupi funksional -X2-L1-X1- ka një strukturë të përzgjedhur nga: *-C(O) -NH-CH(COOH) -R12-NH-C(O) -R13-C(O) -NH- (L-3) , *-C(O) -NH-CH(COOH) -R14-NH-C(O) -R15-C(O) -NH-R16-CH(COOH) -NH-C(O) - (L-4) , dhe *-C(O) -NH-CH(COOH) -R17-C(0) -NH-R18-C(0) -NH-R19-CH(COOH) -NH-C(O) - (L-5) ; ku lidhja e shenjuar me * është bashkuar tek atomi i karbonit që bart R2 në formulën (I) , R12 dhe R14 janë përzgjedhur në mënyrë të pavarur nga alkandiili linear C2 deri në C6, R13 është një alkandiil linear C2 deri në C10, R15 dhe R16 janë përzgjedhur në mënyrë të pavarur nga alkandiili linear C2 deri në C6, dhe ku secili prej R13 dhe R15 mund të bartë një grup EDS si një zëvendësues, R17 është një alkandiil linear C2 deri në C6, R18 është një

grup fenilen, dhe R19 është një alkandiil C2 deri në C6.
6. Përbërja farmaceutike sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 5, ku R2 është një grup aralkil opsionalisht i zëvendësuar i përzgjedhur nga -CH2-fenil opsionalisht i zëvendësuar dhe -CH2-naftil, ku grupi fenil dhe naftil janë opsionalisht të zëvendësuar me një zëvendësues të përzgjedhur nga halogjeni, preferueshëm I, dhe -OH.
7. Përbërja farmaceutike e secilit prej pretendimeve 1 deri në 6, ku R3 është një grup aralkil opsionalisht i zëvendësuar i përzgjedhur nga -CH2-fenil opsionalist i zëvendësuar dhe -CH2-naftil opsionalisht i zëvendësuar, ku grupi fenil dhe naftil janë opsionalisht të zëvendësuar me një zëvendësues të përzgjedhur nga halogjeni dhe -OH.
8. Përbërja farmaceutike e secilit prej pretendimeve 1 deri në 7, ku r është 1, dhe ku R4 është përzgjedhur nga fenil opsionalisht i zëvendësuar, naftil opsionalisht i zëvendësuar, dhe një grup EDS, ku grupi fenil dhe grupi naftil janë opsionalisht të zëvendësuar me një zëvendësues të përzgjedhur nga halogjeni, -OH dhe -NH2.
9. Përbërja farmaceutike e secilit prej pretendimeve 1 deri në 8, ku X3 është një lidhje amide ose një grup me formulën

,

ku lidhja e shenjuar në grupin karbonil bashkon X3 tek RM dhe lidhja tjetër e shenjuar lidh X3 tek pjesa e mbetur e molekulës.
10. Përbërja farmaceutike e secilit prej pretendimeve 1 deri në 9, ku RM është një grup kelatimi i cili opsionalisht përmban një kation jo-radioaktiv të kelatuar ose radioaktiv.
11. Përbërja farmaceutike e secilit prej pretendimeve 1 deri në 10, ku komponimi i formu-lës (I) ose përmban një grup EDS i cili bartet nga grupi bashkues L1 ose përmban dy grupe EDS, njëri përfaqësohet nga R4 dhe njëri bartet nga L1.
12. Përbërja farmaceutike e secilit prej pretendimeve 1 deri në 11, e cila përmban një grup EDS i cili ka formulën (E-2A) :

(E-2A)

ku ∿∿∿ shenjon lidhjen e cila bashkon grupin EDS tek pjesa e mbetur e komponimit të formulës (I) ; dhe

t është 1 ose 2, dhe R6A është përzgjedhur nga -NO2 dhe -COOH.

13. Përbërja farmaceutike e pretendimit 1, ku komponimi i përmendur ose kripa ka njërën prej formulave vijuese:

(Ih)

(Ii)

(Ij)

(Ik)

(Im)

(In)

(Io)

(Ip)

(Iq)

(Ir)

(Is)

14. Një përbërje farmaceutike e pretendimit 1 e cila përmban një komponim që përmban një strukturë me formulën vijuese:

ose kripën e tij

15. Një përbërje farmaceutike e pretendimit 1 e cila përmban një komponim që përmban një strukturë me formulën vijuese:

ose kripën e tij.

16. Një përbërje farmaceutike e pretendimit 1 e cila përmban një komponim që përmban një strukturë me formulën vijuese:

ose kripën e tij.

17. Një përbërje farmaceutike e pretendimit 1 e cila përmban një komponim që përmban një strukturë me formulën vijuese:

ose kripën e tij.

18. Një përbërje farmaceutike e secilit prej pretendimeve 1 deri në 17 për tu përdorur në mjekim.

19. Përbërja farmaceutike për përdorimin e pretendimit 18 ku mjekimi është radioterapi e një sëmundjeje të shoqëruar me mbishprehje të antigjenit specifik të membranës së prostatës (ASMP) .

20. Një përbërje farmaceutike e secilit prej pretendimeve 1 deri në 17 për tu përdorur në trajtimin e kancerit.

21. Përbërja farmaceutike e pretendimit 20, ku kanceri është kancer i prostatës.

(11) **12513**
(97) EP4157876/ 04.09.2024
(96) 21739197.8/ 24.05.2021
(22) 16.10.2024
(21) AL/P/2024/580
(54) **ANTITRUPA ANTI-PD-1**
12.12.2024
(30) US 202063029962 P 26/05/2020 ,US 202063039686 P 16/06/2020
(71) Boehringer Ingelheim International GmbH/ Binger Strasse 173
55216 Ingelheim am Rhein / DE,
(72) BLAIR, David A./Ridgefield, Connecticut 06877-0368 / US, ; GARAFFA, Nicole K./Ridgefield, Connecticut 06877-0368 / US, ; GUPTA, Pankaj/Ridgefield, Connecticut 06877-0368 / US, ; GUPTA, Priyanka/Ridgefield, Connecticut 06877-0368 / US, ; HAN, Fei/Ridgefield, Connecticut 06877-0368 / US, ; KARLAK, Aaron, Timothy/Ridgefield, Connecticut 06877-0368 / US, ; LIU, Dongmei/Ridgefield, Connecticut 06877-0368 / US, ; LORENZ, Ivo/Ridgefield, Connecticut 06877-0368 / US, ; MBOW, Mouhamadou Lamine/Ridgefield, Connecticut 06877-0368 / US, ; MORENO-GARCIA, Miguel E./Ridgefield, Connecticut 06877-0368 / US, ; MOZDZIERZ, Joseph A./Ridgefield, Connecticut 06877-0368 / US, ; RALPH, Kerry L. M./Ridgefield, Connecticut 06877-0368 / US, ; SHAABAN, Abdulsalam/Ridgefield, Connecticut 06877-0368 / US, ; WHITE, Della M./Ridgefield, Connecticut 06877-0368 / US, ; WU, Helen Haixia/Ridgefield, Connecticut 06877-0368 / US, ; YANG, Guangwei/Ridgefield, Connecticut 06877-0368 / US, ,
(74) Ela Panidha
Zhan D'Ark; Nd. 2; H. 3; Ap. 15; Njësia Administrative Nr. 10; Njesia bashkiake nr. 10; 1001; TIRANË
(57) 1. 1. Një antitrup anti-PD-1 ose fragmenti i tij antigjen-bashkues që përmban: një zonë të ndryshueshme të zinxhirit të rëndë që përmban sekuencën amino-acide të SEQ ID NO: 73 (H-CDR1) ; sekuencën aminoacide të SEQ ID NO: 78 (H-CDR2) ; dhe sekuencën aminoacide të SEQ ID NO: 77 (H-CDR3) , dhe një zonë të ndryshueshme të zinxhirit të lehtë që përmban sekuencën aminoacide të SEQ ID NO: 165 (L-CDR1) ; sekuencën aminoacide të SEQ ID NO: 166 (L-CDR2) ; sekuencën aminoacide të SEQ ID NO: 32 (L-CDR3) .
2. Antitrupi anti-PD1 ose fragmenti i tij antigjen-bashkues i pretendimit 1, ku antitrupi i përmendur ose fragment ii tij antigjen-bashkues është përzgjedhur nga grupi që kon-siston në: një antitrup të humanizuar ose fragment të tij antigjen-bashkues, një antitrup monoklonal, një Fab (Fragment antigjen-bashkues) , një F(ab’) 2 (Fragment me 2 an-tigjen-bashkues) , një Fv (Fragment i ndryshueshëm) dhe një scFv (Fragment i ndryshueshëm me zinxhir të vetëm) .
3. Antitrupi anti-PD-1 ose fragmenti i tij antigjen-bashkues i pretendimit 1 ose 2, ku anti-trupi i përmendur ose fragmenti i tij antigjen-bashkues përmban një zonë të ndryshueshme të zinxhirit të rëndë që ka të paktën 90% identitet me sekuencën ami-noacide të SEQ ID NO: 135, dhe një zonë të ndryshueshme të zinxhirit të lehtë që ka të paktën 90% identitet me sekuencën aminoacide të SEQ NO: 127.
4. Antitrupi anti-PD-1 ose fragmenti i tij antigjen-bashkues i secilit prej pretendimeve 1 deri në 3, ku antitrupi i përmendur ose fragmenti i tij antigjen-bashkues përmban një zonë të ndryshueshme të zinxhirit të rëndë dhe një zonë të ndryshueshme të zinxhirit të lehtë që

përmban sekuencat aminoacide të SEQ ID NO: 135 dhe SEQ ID NO: 127, përkatësisht.
5. Antitrupi anti-PD-1 i secilit prej pretendimeve 1 deri në 4, ku antitrupi i përmendur përmban: një zonë konstante të zinxhirit të rëndë të përzgjedhur nga grupi që konsis-ton në: zonat konstante IgG4, IgG1, IgG2, IgG3, IgM, IgA dhe IgE, preferueshëm ku zona konstante e zinxhirit të rëndë është një zonë konstante e zinxhirit të rëndë e një IgG4 me një mutacion Ser228Pro ose ku zona konstante e zinxhirit të rëndë është një zonë konstante e zinxhirit të rëndë e një IgG1 me mutacionet Leu234Ala dhe Leu235Ala.
6. Antitrupi anti-PD-1 ose fragmenti i tij antigjen-bashkues i secilit prej pretendimeve 1 deri në 5, ku antitrupi ose fragmenti i tij antigjen-bashkues përmban një zone kon-stante të zinxhirit të lehtë të përzgjedhur nga grupi që konsiston në kappa dhe lambda.
7. Antitrupi anti-PD-1 i secilit prej pretendimeve 1 deri në 6, ku antitrupi i përmendur përmban një zinxhir të rëndë dhe një zinxhir të lehtë që përmban sekuencat amino-acide të SEQ ID NO: 149 dhe SEQ ID NO: 145, përkatësisht.
8. Një përbërje farmaceutike që përmban antitrupin anti-PD-1 ose fragmentin e tij an-tigjen-bashkues sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 7, dhe një eksipient farma-ceutikisht të pranueshëm.
9. Një antitrup anti-PD-1 ose fragmenti i tij antigjen-bashkues sipas secilit prej pretendi-meve 1 deri në 8 për tu përdorur si një medikament, preferueshëm për tu përdorur në trajtimin e një çrregullimi të shtegut PD-1.
10. Antitrupi anti-PD-1 ose fragmenti i tij antigjen-bashkues për tu përdorur sipas pre-tendimit 9, ku çrregullimi i shtegut PD-1 është një sëmundje inflamatore kronike ose një sëmundje inflamatore akute.
11. Antitrupi anti-PD-1 ose fragmenti i tij antigjen bashkues për tu përdorur sipas pre-tendimit 9 ose 10, ku çrregullimi i shtegut PD-1 është përzgjedhur nga grupi që konsis-ton në: artrit, artrit reumatoid, astmë, COPD (Sëmundja Pulmonare Obstruktive Kronike) , sëmundja inflamatore e pelvisit, Sëmundja Alzheimer, sëmundja inflamatore e zorrës, sëmundja Crohn, kolit ulceroz, Sëmundja Peyronie, sëmundja celiake, sëmundja e fshikëzës së tëmthit, sëmundja Pilonidal, peritonit, psoriasis, artrit psori-atik, vaskulitis, aderencat (ngjitjet) kirurgjikale, goditja në tru, Diabet i Tipit I, sëmundja Lyme, meningoencefalit, uveit autoimun, skleroza e shumëfishtë, lupus, eritematoza sistemike lupus, sindroma Guillain-Barré, dermatit Atopik, hepatit autoimun, alveolit fibroz, sëmundja Grave, nefropatia IgA, purpura trombocitopenike idiopatike, sëmundja Meniere, pemphigus, ciroza biliare parësore, sarkoidozë, sklero-dermë, granulomatozë Wegner, çrregullime të tjera autoimune, pankreatit, traumë, ki-rurgji, sëmundja graft kundër bujtësit, refuzimi i transplantit, sëmundja e zemrës duke përfshirë sëmundjet ishemike të tilla si infarkti i miokardit si dhe aterosklerozën, koagulim intravaskular, resorbim i kockave, osteoporozë, osteoartrit, periodontitis dhe hipoklorhidria, infertilitet i lidhur me mungesën e tolerancës fetalo-maternale, Sindro-ma Sjorgen, vitiligo, myasthenia gravis dhe sklerozë sistemike; dhe/ose ku çrregullimi i shtegut PD-1 është përzgjedhur nga grupi që konsiston në: sklerozë sistemike, eritematoza sistemike lupus, polymyositis, arterit me qeliza gjigande, psori-asis, artrit psoriatik, spondilit ankilozant dhe sëmundjen inflamatore të zorrës.
12. Antitrupi anti-PD-1 ose fragmenti i tij antigjen-bashkues për tu përdorur sipas secilit prej pretendimeve 9 deri në 11, ku antitrupi i përmendur ose fragmenti i tij antigjen-bashkues administrohet nëpërmjet një rruge parenterale, rrugë intravenoze ose rrugë nënlëkurore administrimi.
13. Një polinukleotid i izoluar që kodon një antitrup anti-PD-1 ose fragmenti i tij antigjen-bashkues sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 7.

14. Një vektor shprehës që përmban një polinukleotid sipas pretendimit 13.
15. Një qelizë pritëse që përmban një vektor shprehës sipas pretendimit 14, preferueshëm ku qeliza është një qelizë gjitarësh.
16. Një metodë për të prodhuar një antitrup që përmban hapat vijues: - mbjelljen e një qelize pritëse që përmban një vektor shprehës i cili përmban një polinukleotid që kodon një zonë të ndryshueshme të zinxhirit të rëndë sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 4 dhe një vektor shprehës që përmban polinukleotidin që kodon zonën përkatëse të ndryshueshme të zinxhirit të lehtë sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 4, preferueshëm një vektor shprehës që përmban një polinukleotid që kodon një zinxhir të rëndë sipas secilit prej pretendimeve 5 deri në 7 dhe një vektor shprehës që përmban një polinukleotid që kodon një zinxhir të lehtë sipas secilit prej pretendimeve 5 deri në 7, në kushtet që lejojnë formimin e një antitrupi; dhe - ripërftimin e antitrupit të përmendur; opsionalisht ku metoda më tej përmban hapin e purifikimit të antitrupit të përmendur dhe/ose hapin e formulimit të antitrupit të përmendur në një përbërje farmaceutike.
17. Një antitrup shumë-specifik që përmban një vend të parë antigjen-bashkues agonist anti-PD-1 dhe një vend të dytë antigjen-bashkues, ku vendi i parë antigjen-bashkues agonist anti-PD-1 i përmendur përmban një zonë të ndryshueshme zinxhiri të rëndë dhe një zonë të ndryshueshme zinxhiri të lehtë sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 4.
18. Antitrupi shumë-specifik i pretendimit 17, ku vendi i dytë antigjen-bashkues i përmendur është një vend bashkues i anti-CD48, një vend bashkues i anti-CD2, një vend bashkues i anti-CD11a ose një vend bashkues i anti-CD3 dhe/ose ku antitrupi i përmendur është një antitrup bi-specifik.

---

(11) **12514**
(97) EP3661562/ 02.10.2024
(96) 18759787.7/ 03.08.2018
(22) 17.10.2024
(21) AL/P/2024/586
(54) **METODA E KONJUGIMIT TË CIS-MABS**
12.12.2024
(30) US 201762541522 P 04/08/2017
(71) Amgen Inc./ One Amgen Center Drive, Thousand Oaks, California 91320-1799 / US,
(72) Michal ACHMATOWICZ/1655 Woodscent Lane
Simi Valley California 93065 / US, ; Dante ROMANINI/5921 Tobias Avenue
Sherman Oaks California 91411 / US, ; James R. FALSEY/13209 Peach Hill Road
Moorpark California 93021 / US, ; Bradley J. HERBERICH/1746 Hays Drive
Newbury Park California 91320 / US, ; Oliver R. THIEL/5174 Via Pisa
Thousand Oaks California 91320 / US, ,
(74) Krenar Loloçi
ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË
(57) 1. Një metodë për përgatitjen e një konjugati antitrupi ose konjugati të fragmentit të antitrupit, metoda përfshin hapat e: a) përftimit të një kompozimi që përfshin një antitrup ose fragment antitrupi; b) ekspozimit të antitrupit ose fragmentit të antitrupit tek një agjent që bllokon cisteinën, ku agjenti që bllokon cisteinën është cisteaminë dhe agjenti që bllokon cisteinën formon një disulfid-të përzier të qëndrueshëm me të paktën një mbetje cisteine të

antitrupit ose fragmentit të antitrupit; c) shtimit të një mbetje agjenti te kompozimi për të formuar një përzierje reduktimi dhe lejimin e reaksionit të reduktimit të ndodhë në mënyrë të tillë që përzierja e reduktimit përfshin një mbetje antitrupi ose mbetje të fragmentit të antitrupit, ku agjenti reduktues është trifenilfosfine-3,3',3'-trisulfonate ('TPPTS') ; d) shtimit të një agjenti oksidues tek përzierja e reduktimit për të formuar një përzierje të oksiduar dhe lejimin e një reaksioni oksidues të ndodhë në mënyrë të tillë që përzierja e oksidimit përfshin një antitrup të oksiduar ose fragment të antitrupit të oksiduar; dhe e) shtimit të një pjese kimike të aktivizuar tek përzierja e oksiduar për të formuar një përzierje konjugate dhe lejimin e një reaksioni konjugati të ndodhë në mënyrë të tillë që një konjugat antitrupi ose konjugati i fragmentit të antitrupit është formuar.
2. Metoda sipas pretendimit 1, ku përzierja disulfide është një antitrup ose fragment antitrupi me një cisteinë të lirë të mbuluar.
3. Metoda sipas pretendimit 1, ku hapi vijues b) dhe hapi i mëparshëm c) kromatografia e shkëmbimit të kationeve kryhet për të hequr agjentin bllokues të tepërt të cisteinës.
4. Metoda sipas pretendimit 1, ku raporti i agjentit reduktues të antitrupit ose fragmentit të antitrupit është 2 deri në 4:1 (mol/mol) .
5. Metoda sipas çdo pretendimit të mëparshëm, ku hapi vijues c) dhe hapi i mëparshëm d) kryhet një hap shkëmbimi buferik për të hequr agjentin reduktues.
6. Metoda sipas pretendimit 5, ku hapi i shkëmbimit të buferit është ultrafiltrimi/diafiltrimi.
7. Metoda sipas çdo pretendimi të mëparshëm, ku agjenti oksidues është acidi dehidroaskorbik ('DHAA') .
8. Metoda sipas pretendimit 7, ku raporti i agjentit oksidues me antitrupin ose fragmentin e antitrupit është 3 deri në 6:1 (mol/mol) .
9. Metoda sipas çdo pretendimi të mëparshëm, ku pjesa kimike e aktivizuar është një peptid që përmban një halogjen, ku halogjeni është zgjedhur nga grupi i përbërë prej Br, I, dhe Cl.
10. Metoda sipas pretendimit 9, ku raporti i pjesës kimike të aktivizuar me antitrupin ose fragmentin e antitrupit është 2 deri në 3:1 (mol/mol) .
11. Metoda sipas çdo pretendimi të mëparshëm, ku hapi vijues e) , kryhet një hap pastrimi për të hequr pjesën kimike të aktivizuar.
12. Metoda sipas pretendimit 11, ku hapi i pastrimit përfshin kromatografinë e ndërveprimit hidrofobik ('HIC') , ultrafiltrimin/diafiltrimin, ose kromatografinë e ndërveprimit hidrofobik ('HIC') e ndjekur nga ultrafiltrimi/diafiltrimi.
13. Një metodë për përgatitjen e një konjugati të antitrupit ose një konjugati të fragmentit të antitrupit, metoda që përfshin hapat e: a) përftimit të një kompozimi që përfshin një përzierje disulfide që përfshin një antitrup ose fragment antitrupi me një cisteinë të lirë të mbuluar që përfshin një mbulesë cisteamine; b) shtimit të një agjenti reduktues tek kompozimi për të formuar një përzierje reduktuese dhe lejimin e një reaksioni reduktues të ndodhë në mënyrë të tillë që përzierja e reduktimit të përmbajë një antitrup të reduktuar ose një fragment antitrupi të reduktuar, ku agjenti reduktues është trifenilfosfina-3, 3',3'-trisulfonat ('TPPTS') ; c) shtimit të një agjenti oksidues në përzierjen reduktuese për të formuar një përzierje të oksiduar dhe duke lejuar që të ndodhë një reaksion oksidues në mënyrë që përzierja oksiduese të përmbajë një antitrup të oksiduar ose një fragment antitrupi të oksiduar; dhe d) shtimit të një pjese kimike të aktivizuar në përzierjen e oksiduar për të formuar një përzierje konjugate dhe lejimin e një reaksioni konjugati të tillë që të formohet një konjugat i antitrupit ose fragmentit të antitrupit.
14. Metoda sipas pretendimit 13, ku hapi vijues a) dhe hapi i mëparshëm b) kromatografia e shkëmbimit të kationeve kryhet për të hequr agjentin bllokues të tepërt të cisteinës.

15. Metoda sipas pretendimit 13, ku raporti i agjentit reduktues ndaj antitrupit ose fragmentit të antitrupit është 2 deri në 4:1 (mol/mol) .
16. Metoda sipas çdo njërit prej pretendimeve 13-15, ku hapi vijues b) dhe hapi i mëparshëm c) kryhet një hap shkëmbimi buferik për të hequr agjentin reduktues.
17. Metoda sipas pretendimit 16, ku hapi i shkëmbimit të buferit është ultrafiltrimi/diafiltrimi.
18. Metoda sipas çdo njërit prej pretendimeve 13-17, ku agjenti oksidues është acidi dehidroaskorbik ('DHAA') .
19. Metoda sipas pretendimit 18, ku raporti i agjentit oksidues me antitrupin ose fragmentin e antitrupit është 3 deri në 6:1 (mol/mol) .
20. 20. Metoda sipas çdo njërit prej pretendimeve 13-19, ku pjesa kimike e aktivizuar është një peptid që përmban një halogjen, ku halogjeni është zgjedhur nga grupi që përbëhet prej Br, I, dhe Cl.
21. Metoda sipas pretendimit 20, ku raporti i pjesës kimike të aktivizuar me antitrupin ose fragmentin e antitrupit është 2 deri në 3:1 (mol/mol) .
22. Metoda sipas çdo njërit prej pretendimeve 13-21, ku hapi vijues d) , kryhet një hap pastrimi për të hequr pjesën kimike të aktivizuar.
23. Metoda sipas pretendimit 22, ku hapi i pastrimit përfshin kromatografinë e ndërveprimit hidrofobik ('HIC') , ultrafiltrimin/diafiltrimin ose kromatografinë e ndërveprimit hidrofobik ('HIC') e ndjekur nga ultrafiltrimi/diafiltrimi.
24. Metoda sipas çdo pretendimi të mëparshëm, ku antitrupi ose fragmenti i antitrupit përfshin një mbetje cisteine në një pozicion zgjedhur nga grupi i përbërë prej D70 prej antitrupit të zinxhirit të lehtë i afërt me referencën e sekuencës SEQ ID NO: 7; E276 prej antitrupit të zinxhirit të rëndë i afërt me referencën e sekuencës SEQ ID NO: 8; dhe T363 prej antitrupit të zinxhirit të rëndë i afërt me referencën e sekuencës SEQ ID NO: 8.

---

(11) **12515**
(97) EP4050864/ 24.07.2024
(96) 22158683.7/ 24.02.2022
(22) 17.10.2024
(21) AL/P/2024/587
(54) **METODA PËR PARAQITJE TË OBJEKTEVE TË NJË RRJETI NË NJË GUI**
12.12.2024
(30) US 202117187821 28/02/2021
(71) Nozomi Networks Sagl/ Via Maria Ghioldi-Schweizer 2
6850 Mendrisio / CH
(72) DI FRANCESCANTONIO, Paolo/21040 Castronno / IT, ; CAVALLARO CORTI, Alessandro/21100 Varese / IT, ; CARULLO, Moreno/21026 Gavirate / IT, ; CARCANO, Andrea/San Francisco, 94109 / US, ,
(74) Aleksandra Meçaj // Myslym Shyri; Nd. 0; ; ; Njësia Administrative Nr. 10; Njesia bashkiake nr. 10; 1001; TIRANË
Myslym Shyri; Nd. 0; ; ; Njësia Administrative Nr. 10; Njesia bashkiake nr. 10; 1001; TIRANË
(57) 1. Metodë për paraqitjen e objekteve të një rrjeti në një faqe grafike të përdoruesit, GUI, që përfshin:

- vendosjen e të gjitha objekteve të përmendura të rrjetit në fjalë si nyje përkatëse në një hapësirë dy-dimensionale;
- vlerësimin e forcave gravitacionale të nyjeve në fjalë; dhe
- pozicionimin e objekteve të përmendura si grafik në GUI në fjalë, bazuar në forcat gravitacionale në fjalë të nyjeve në fjalë;
ku alokimi në fjalë përfshin:

- përcaktimin, me anë të një njësie të përpunimit të kompjuterizuar të të dhënave, një pozicion fillestar të rastësishëm të të gjitha nyjeve të përmendura duke i caktuar secilës prej nyjeve në fjalë koordinatat përkatëse përgjatë akseve x dhe y në hapësirën dydimensionale të përmendur;
- mbylljen, nga njësia në fjalë e përpunimit të kompjuterizuar të të dhënave, e të gjitha nyjeve të përmendura në një kuadrat të vetëm bazë në hapësirën dy-dimensionale në fjalë;
- ndarjen, nga njësia në fjalë e përpunimit të kompjuterizuar të të dhënave, e kuadratit bazë të vetëm në fjalë në një sasi kuadratësh të nivelit të parë në hapësirën dydimensionale në fjalë, ku sasia në fjalë e kuadratëve të nivelit të parë përbëhet nga katër kuadrate të nivelit që kanë përmasa të njëjta në hapësirën dydimensionale në fjalë;
- nënndarjen, nga njësia në fjalë e përpunimit të kompjuterizuar të të dhënave, të secilit prej kuadratëve të nivelit të parë në një sasi kuadratësh të nivelit të dytë në hapësirën dydimensionale të përmendur, ku nënndarja në fjalë është bërë për kuadratët e nivelit të parë të pajisur me dy ose më shumë prej nyjeve dhe ku secila nga sasitë e përmendura të kuadratëve të nivelit të dytë përbëhet nga katër kuadrate niveli që kanë të njëjtat dimensione;
- përsëritjen, nga njësia në fjalë e përpunimit të kompjuterizuar të të dhënave, nënndarja në fjalë e secilit prej kuadratëve të nivelit të (n) në një sasi kuadratësh të nivelit të (n+1) në hapësirën dydimensionale në fjalë, ku nënndarja në fjalë është bërë për kuadratët në fjalë (n) të nivelit të pajisur me dy ose më shumë nga nyjet e përmendura dhe ku secili nga sasia e (n+1) e kuadratëve të nivelit të përmendur përbëhet nga katër kuadratë të nivelit që kanë të njëjtat dimensione;

ku vlerësimi në fjalë përfshin:

- zgjedhjen, nga njësia e përpunimit të kompjuterizuar të të dhënave, si kuadrat burimi të forcave gravitacionale në fjalë, duke filluar nga niveli më i lartë që korrespondon me nivelin e parë;
- zgjedhjen, nga njësia e përpunimit të kompjuterizuar të të dhënave, si kuadrat marrës të forcave gravitacionale në fjalë, një nga kuadratët e përmendur duke filluar nga niveli më i lartë në fjalë;
- vlerësimin, sipas njësisë së përpunimit të kompjuterizuar të të dhënave, nëse kuadrati i burimit dhe kuadrati i marrësit në fjalë janë të largëta nga njëri-tjetri, sipas një ose më shumë kritereve të paracaktuara;
- llogaritjen, nga njësia në fjalë e përpunimit të kompjuterizuar të të dhënave, e forcave që veprojnë në kuadratin e marrësit në fjalë nga kuadrati i burimit të përmendur, nëse kuadrati i burimit në fjalë dhe kuadrati i marrësit në fjalë vlerësohen si të largëta, ose nëse kuadrati i burimit të përmendur dhe kuadrati i marrësit në fjalë vlerësohen si jo të largëta dhe nuk kanë përkatësisht asnjë kuadrat të nivelit më të ulët të mbivendosur;
- nën-zgjedhjen, nga njësia në fjalë e përpunimit të kompjuterizuar të të dhënave, si kuadrat burimi ose si kuadrat marrës i njërit prej kuadratëve të përmendur të një niveli më të ulët,

nëse kuadrati i burimit në fjalë dhe kuadrati i marrësit në fjalë vlerësohen si jo të largëta, ku nën-zgjedhja në fjalë përsëritet për të gjithë kombinimet e kuadratëve të përmendur në të njëjtin nivel si burim dhe si marrës për të gjitha nivelet e përmendura;

ku forcat në fjalë që veprojnë në secilin nga kuadratët e marrësit në fjalë janë dy komponentët e forcës së krijuar përgjatë boshteve x dhe y në hapësirën dydimensionale në fjalë, të llogaritura si:

$$Fgx = G\ Ms * (xs - xr) / d^3$$

$$Fgy = G\ Ms * (ys - yr) / d^3$$

ku:

- Ms është masa e burimit,
- xs, ys janë koordinatat e qendrës së burimit të masës,
- xr, yr janë koordinata e qendrës së marrësit të masës,
- d është distanca midis qendrës së burimit të masës në fjalë dhe qendrës së marrësit të masës,
- G është një konstante gravitacionale e paracaktuar,

ku vlerësimi në fjalë përsëritet për të gjitha kombinimet e kuadratëve të përmendur në nivelin e 1-rë si burim dhe si marrës; dhe
ku vlerësimi në fjalë përfshin më tej shpërndarjen, nga njësia në fjalë e përpunimit të kompjuterizuar të të dhënave, të forcave në fjalë që veprojnë në secilin prej kuadratëve të marrësit në fjalë tek të gjitha nyjet e përmendura në kuadratin e marrësit përkatës që përcaktojnë forcat gravitacionale në fjalë të të gjitha nyjeve të përmendura.
2. Metoda për paraqitjen e objekteve të një rrjeti në një GUI sipas pretendimit 1, ku kriteret e paracaktuara në fjalë përfshijnë vlerësimin e mbivendosjes, ku kuadratët e përmendur konsiderohen jo të largët nëse mbivendosen me njëri-tjetrin.
3. Metoda për paraqitjen e objekteve të një rrjeti në një GUI sipas pretendimit 1 ose 2, ku kriteret e paracaktuara në fjalë përfshijnë vlerësimin e skajeve, ku kuadratët e përmendur konsiderohen jo të largët nëse kanë të paktën një skaj të përbashkët.
4. Metoda për paraqitjen e objekteve të një rrjeti në një GUI sipas njërit prej pretendimeve 1-3, ku kriteret e paracaktuara në fjalë përfshijnë vlerësimin e kulmeve, ku kuadratët në fjalë konsiderohen jo të largët nëse kanë të paktën një kulm të përbashkët.
5. Metoda për paraqitjen e objekteve të një rrjeti në një GUI sipas njërit prej pretendimeve 1-4, ku shpërndarja në fjalë përfshin për secilën nga nyjet e përmendura që përcaktojnë forcat gravitacionale në fjalë si forcat që veprojnë në kuadratin e marrësit përkatës të shumëzuar me masën e nyjes në fjalë.
6. Metoda për paraqitjen e objekteve të një rrjeti në një GUI sipas pretendimit 5, ku forcat e lartpërmendura gravitacionale për secilën nga nyjet e përmendura përcaktohen duke filluar nga kuadrati i marrësit në nivelin më të ulët dhe duke shkuar deri në kuadratin e marrësit prind në nivelin më të lartë,
ku forcat e lartpërmendura gravitacionale të nyjës në fjalë llogariten si shuma e forcave që veprojnë në secilin prej kuadratit të marrësit përkatës nga niveli më i ulët në fjalë, shumëzuar

me masën e nyjës në fjalë.
7. Metoda për përfaqësimin e objekteve të një rrjeti në një GUI sipas njërit prej pretendimeve 1-6, ku nën-zgjedhja e përmendur përfshin zgjedhjen si kuadrat të nivelit më të ulët të atij ndërmjet kuadratit të burimit dhe kuadratit të marrësit në nivel më të lartë, nëse edhe kuadrati i burimit dhe kuadrati i marrësit kanë kuadratë të nivelit më të ulët të mbivendosur dhe nuk janë në të njëjtin nivel.
8. Metoda për përfaqësimin e objekteve të një rrjeti në një GUI sipas njërit prej pretendimeve 1-7, ku nën-zgjedhja në fjalë përfshin zgjedhjen si kuadrat të nivelit më të ulët të atij ndërmjet kuadratit të burimit dhe kuadratit marrës që ka kuadratë të nivelit më të ulët të mbivendosur nëse tjetri ka nuk ka kuadratë të nivelit më të ulët të mbivendosur.
9. Metoda për paraqitjen e objekteve të një rrjeti në një GUI sipas njërit prej pretendimeve 1-8, ku nën-zgjedhja përfshin zgjedhjen si kuadrat të nivelit më të ulët të atij ndërmjet kuadratit të burimit dhe kuadratit marrës që përmban më pak numër të nyjeve në fjalë, nëse të dyja kuadrati i burimit dhe kuadrati i marrësit kanë kuadratë të nivelit më të ulët të mbivendosur dhe janë në të njëjtin nivel.
10. Metoda për paraqitjen e objekteve të një rrjeti në një GUI sipas njërit prej pretendimeve 1-9, ku nën-zgjedhja përfshin zgjedhjen si kuadrat të nivelit më të ulët kuadratin e marrësit, nëse si kuadrati i burimit ashtu edhe kuadrati i marrësit kanë kuadratë të nivelit më të ulët të ndërthurur dhe përmbajnë të njëjtin numër nyjesh në fjalë.
11. Metoda për përfaqësimin e objekteve të një rrjeti në një GUI sipas njërit prej pretendimeve 1-10, ku pozicionimi në fjalë i objekteve në GUI në fjalë bazohet në forcat gravitacionale të nyjeve në fjalë dhe në forcat e lidhjes midis çifteve të nyjeve të përmendura.
12. Metoda për paraqitjen e objekteve të një rrjeti në një GUI sipas pretendimit 11, ku forcat e lidhjes në fjalë llogariten për secilin prej çifteve të përmendura si:

$$Flx = K\ (xb - xa)$$

$$Fly = K\ (yb - ya)$$

dhe

$$Flx = K\ (xa - xb)$$

$$Fly = K\ (ya - yb)$$

përkatësisht për një nyje 'a' të çiftit në fjalë dhe për një nyje 'b' të çifti në fjalë, ku:

- K është një konstante elastike e paracaktuar;
- xa, xb janë koordinatat përkatëse përgjatë boshtit x të nyjeve 'a' dhe 'b';
- ya, yb janë koordinatat përkatëse përgjatë boshtit y të nyjeve 'a' dhe 'b'.

13. Metoda për përfaqësimin e objekteve të një rrjeti në një GUI sipas njërit prej pretendimeve 1-12, ku pozicionimi i përmendur i objekteve në GUI në fjalë bazohet në forcat gravitacionale të nyjeve në fjalë dhe në forcat qendrore që tërheqin nyjet në fjalë drejt

origjinës të grafikut në fjalë.
14. Metoda për paraqitjen e objekteve të një rrjeti në një GUI sipas pretendimit 13, ku forcat qendrore në fjalë llogariten për secilën nga nyjet në fjalë si:

$$Fcx = C * x$$

$$Fcy = C * y$$

ku:

- C është një konstante e paracaktuar;
- x është koordinata përgjatë boshtit x të një nyje;
- y është koordinata përgjatë boshtit y të një nyje.

15. Metoda për përfaqësimin e objekteve të një rrjeti në një GUI sipas njërit prej pretendimeve 1-14, ku pozicionimi i objekteve të përmendura në GUI në fjalë bazohet në forcat gravitacionale të nyjeve në fjalë dhe në forcat e amortizimit të nyjeve në fjalë.
16. Metoda për paraqitjen e objekteve të një rrjeti në një GUI sipas pretendimit 15, ku forcat amortizuese llogariten për secilën nga nyjet e përmendura si:

$$Fdx = D * Vx$$

$$Fdy = D * Vy$$

ku

- Vx është shpejtësia e nyjes në fjalë përgjatë boshtit x në fjalë,
- Vy është shpejtësia e nyjës në fjalë përgjatë boshtit y në fjalë,
- D është një konstante e paracaktuar e amortizimit.

17.
Metoda për përfaqësimin e objekteve të një rrjeti në një GUI sipas njërit prej pretendimeve 1-11 dhe 11-16, ku pozicionimi i përmendur i objekteve në GUI në fjalë bazohet në forcat totale të secilës prej nyjeve në fjalë si shuma e forcave gravitacionale në fjalë, të forcave të lidhjes në fjalë, të forcave qendrore në fjalë, të forcave të amortizimit në fjalë të llogaritura për secilën nga nyjet në fjalë si:

$$Ftx = Fgx + Flx + Fcx + Fdx$$

$$Fty = Fgy + Fly + Fcy + Fdy$$

18. Metoda për përfaqësimin e objekteve të një rrjeti në një GUI sipas pretendimit 17, ku pozicionimi në fjalë i objekteve në GUI-në në fjalë llogaritet në një interval kohor të

paracaktuar në çdo moment të paracaktuar,
dhe ku një pozicion i ri i të gjitha nyjeve të fjalë në çastin në fjalë është përcaktuar duke pëdorur Algoritmin Verlet-Shpejtësi bazuar në forcat totale në fjalë.

---

(11) **12516**
(97) EP4249703/ 11.09.2024
(96) 23159860.8/ 03.03.2023
(22) 21.10.2024
(21) AL/P/2024/588
(54) **PAJISJE PËR TË MBAJTUR NJË DYSHEME TË NGRITUR**
12.12.2024
(30) IT IT202200005153 16/03/2022
(71) Italprofili S.r.l./ Via Enrico Fermi, 2, 30020 Torre di Mosto (VE) / IT,
(72) Marco GOTTARDO/30020 Torre di Mosto (VE) / IT, ,
(74) Krenar Loloçi// ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË
(57) 1. Pajisja mbështetëse për një dysheme të ngritur, veçanërisht për jashtë, që përfshin një bazë (2) për t'u mbështetur në një pllakë mbështetëse të dyshemesë së ngritur, një mëngë të filetuar (4) , e cila mund të lidhet me një dado të filetuar (10) të bazës së përmendur (2) dhe një kokë (6,6',6') e kufizuar në mënyrë të lëvizshme në mëngën e përmendur me filetim (4) , në të cilën mënga e përmendur me filetim (4) paraqet një disk mbyllës të sipërm (14) , duke paraqitur të paktën një shtojcë radiale (22) , e konfiguruar për t'u futur me bajonetë në një hapje radiale përkatëse (32) të përftuar në një fllanxhë unazore (30) të parashikuar në kokën e përmendur (6,6',6') kur kjo është e lidhur me mëngën e filetuar (4) , e karakterizuar në atë që dy dhëmbët (34) janë dhënë në anët e hapjes radiale të përmendur (32) , që kanë një anë të pjerrët përballë hapjes së përmendur (32) dhe një anë në thelb ortogonale me rrafshin e fllanxhës (30) , përballë, dhe atë shtojcë radiale të përmendur (22) është i pajisur me fleksibilitet të përshtatshëm për të lejuar rrjedhjen e tij elastike gjatë rrëshqitjes përgjatë anës së pjerrët të njërit prej dhëmbëve të përmendur (34) pas rrotullimit të mëngës së filetuar (4) në lidhje me kokën e përmendur (6,6',6 ') rrotullimi i cili rezistohet kur shtojca radiale e përmendur (22) mbështetet kundër anës së përmendur ortogonale.
2. Pajisja mbështetëse sipas pretendimit 1, e karakterizuar në atë që disku i sipërm mbyllës (14) paraqet të paktën tre shtojca radiale të barazkëndore (22) të konfiguruara për të bashkëpunuar me po aq hapje radiale (32) .
3. Pajisja mbështetëse sipas një ose më shumë prej pretendimeve të mëparshëm, karakterizuar në atë që nga disku i sipërm mbyllës (14) i mëngës së përmendur me filetim (4) një reliev cilindrik (16) niset në mënyrë boshtore nga jashtë, nga i cili shtojcat radiale të përmendur (22) .
4. Pajisja mbështetëse sipas një ose më shumë prej pretendimeve të mëparshme, karakterizuar në atë që numri, dimensionet dhe rregullimi i shtojcave radiale e përmendur (22) dhe i dhëmbëve të përmendur (34) janë të tilla që të parandalojnë rrotullimet reciproke që tejkalojnë vlerat këndore të paracaktuara kur mënga me fileto e përmendur (4) është shoqëruar me kokën e përmendur (6,6',6') .
5. Pajisja mbështetëse sipas një ose më shumë nga treguesit e mëparshëm, e karakterizuar në atë që koka e përmendur (6, 6', 6') është e lidhur në sipërfaqen e sipërme me anë të mjeteve (26, 36, 39) për përbërësit e përputhshëm/kufizues (24, 38, 38') të dyshemesë së ngritur.

6. Pajisja mbështetëse sipas një ose më shumë prej pretendimeve të mëparshme, e karakterizuar në atë që baza e përmendur (2) paraqet elementë radialë ngurtësues (12) , të konfiguruar për kapje të lehtë nga një instalues gjatë rrotullimit të bazës së përmendur (2) në lidhje me mëngën e përmendur me filetim (4) .
7. Pajisja mbështetëse sipas një ose më shumë prej pretendimeve të mëparshme, e karakterizuar në atë që për realizimin e dyshemeve me pllaka (24) sipërfaqja e sipërme e kokës së përmendur (6) paraqet shtojca të sheshta (26) që dalin lart, të cilat vendosen në rrafshe diametrale dhe përbëjnë ndarëse për përcaktimin e pozicionit të saktë reciprok të pllakave të përmendura (24) duke u mbështetur me pjesën e tyre të këndit në kokën e përmendur (6) , trashësia e secilës prej shtojcave të përmendura që korrespondon me gjerësinë e fugave midis pllakave të dyshemesë.
8. Pajisja mbështetëse sipas pretendimit 7, e karakterizuar në atë që koka e përmendur lidhet me katër shtojca (26) të vendosura në dy plane ortogonale.
9. Pajisja mbështetëse sipas një ose më shumë prej pretendimeve nga 1 deri në 6, e karakterizuar në atë që për ndërtimin e një dyshemeje me një nënstrukturë trarësh dhe përfundim me shufra, koka e përmendur (6',6') paraqet të paktën një zgjatje (36, 39) për lidhjen e një profili (38, 38') të nënstrukturës së përmendur me një trarë.
10. Pajisja mbështetëse sipas pretendimit 9, e karakterizuar në atë që koka e përmendur (6') paraqet të paktën dy palë zgjatime (36) të konfiguruara dhe të rregulluara në mënyrë që të fiksojnë profilin e përmendur (38) në dy skajet e tij anësore.
11. Pajisja mbështetëse sipas pretendimit 10, e karakterizuar në atë që koka e përmendur (6') paraqet katër palë zgjatime (36) të rregulluara në mënyrë që të fusin profilin (38) në një nga dy rregullimet e rrotulluara 90° me njëri-tjetrin.
12. Pajisja mbështetëse sipas pretendimit 9, e karakterizuar në atë që koka e përmendur (6') është e pajisur me një zgjatje (39) , e cila zhvillohet në mënyrë lineare dhe paraqet të paktën një vrimë për kalimin e një videje (40) që synon të kufizojë profilin e përmendur (38') me angazhim në njërën skaj të saj.
13. Pajisja mbështetëse sipas një ose më shumë prej pretendimeve të mëparshme, e karakterizuar në atë që në gjendjen e montuar sipërfaqja e poshtme e kokës së pëmendur (6,6',6') mbështetet në skajin e sipërm të mëngës së përmendur me filetim (4) .
14. Pajisja mbështetëse sipas një ose më shumë prej pretendimeve të mëparshme, e karakterizuar në atë që sipërfaqja e poshtme e kokës së përmendur (6, 6', 6') përfshihet në një reliev unazor (42) me një profil në formën e një segmenti sferik, i cili kur koka e përmendur është e lidhur me mëngën e përmendur me filetim (4) dhe mbështetet në një reliev unazor në formë kundërta (44) të parashikuar në diskun e sipërm mbyllës (14) të mëngës së përmendur me filetim (4) .
15. Pajisja mbështetëse sipas pretendimit 14, e karakterizuar në atë që sipërfaqja e poshtme e kokës së përmendur (6, 6', 6') ka të bëjë me një reliev unazor (42) me një profil në formën e një segmenti sferik konkav.

---

(11) **12529**
(97) EP3998067/ 11.09.2024
(96) 21204193.3/ 09.11.2016
(22) 24.10.2024
(21) AL/P/2024/597
(54) **KOMPOZIMET DHE METODAT PËR TRAJTIMIN E HOMOCISTINURIA-S**

16.12.2024
(30) US US201514935690 09/11/2015
(71) The Regents of the University of Colorado, A Body Corporate/ 1800 Grant Street, 8th Floor, Denver, CO 80203 / US,
(72) Jan P. Kraus/Littleton, CO 80123 / US, ; Tomas Majtan/Aurora, CO 80011 / US, ; Erez Bublil/4481600 Ets Efraim / IL, ,
(74) Krenar Loloçi
ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË
(57) 1. Një kompozim që përfshin një polipeptid mutant të izoluar të kufizuar nga cistationina beta e sintazës (htCBS) së njeriut e konjuguar te një pjesë PEG, ku polipeptidi mutant i izoluar htCBS përfshin sekuencën e amino acidit të SEQ ID NO:3 me një ndryshim të një cisteine në pozicionin e amino acidit që korrespondon tek 15 prej SEQ ID NO:3 te një serinë dhe mungesa e mbetjes së parë të metioninës së N-terminalit që korrespondon tek SEQ ID NO:3, dhe është PEGiluar me ME-200GS; për përdorim në një metodë të trajtimit të homocistinuria-s në një subjekt njeri, ku polipeptidi mutant i PEGiluar htCBS është administruar të paktën një herë në javë për të paktën gjashtë javë në një dozë ndërmjet 0.33 dhe 10 mg/kg.
2. Kompozimi për përdorim i pretendimit 1, ku doza është një sasi zgjedhur nga grupi i përbërë prej: 0.33, 0.5, rreth 1, rreth 2, dhe rreth 5 mg/kg.
3. Kompozimi për përdorim i pretendimit 1, ku doza është rreth 0.4 mg/kg.
4. Kompozimi për përdorim i pretendimit 1, ku polipeptidi mutant i PEGiluar htCBS është administruar të paktën dy herë në javë.
5. Kompozimi për përdorim i pretendimit 1, ku polipeptidi mutant i PEGiluar htCBS është bashkë-administruar me betainë.
6. Kompozimi për përdorim i pretendimit 1, ku betaina është administruar përpara polipeptidit mutant të PEGiluar htCBS.

---

(11) **12532**
(97) EP3684786/ 14.08.2024
(96) 18773448.8/ 24.09.2018
(22) 29.10.2024
(21) AL/P/2024/599
(54) **GLIKOPROTEINA MUTAGJENE E VIRUSIT TË STOMATITIT VEZIKULAR**
16.12.2024
(30) EP 17306255 22/09/2017
(71) Centre National de la Recherche Scientifique (CNRS)/ 3, rue Michel Ange, 75016 Paris / FR, ; Université Paris-Saclay/ Bâtiment Breguet, 3 rue Joliot Curie, 91190 Gif-sur-Yvette / FR,
(72) Aurélie ALBERTINI/3 avenue Pierre Curie
91940 Gometz le Chatel / FR, ; Yves GAUDIN/4 rue Léon Delagrange
75015 Paris / FR, ; Hélène RAUX/1 allée des impressionnistes
92160 Antony / FR, ; Laura BELOT/11 rue des Fougères
78310 Maurepas / FR, ; Jovan NIKOLIC/326 rue Lecourbe
75015 Paris / FR, ,

(74) Krenar Loloçi
ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË
(57) 1. Një proteinë e izoluar jo natyrale që përfshin sekuencën e aminoacideve siç përcaktohet në SEQ ID NO: 1, e cila është sekuenca e aminoacideve të ektodominës së variantit VSV Indiana, ku aminoacidi në pozicionin 47 ose në pozicionin 354, ose në të dy pozicionet 47 dhe 354, numërimi i përmendur bëhet nga pozicioni i aminoacidit të parë në sekuencën SEQ ID NR: 1, është (janë) zëvendësuar nga një aminoacid i ndryshëm nga aminoacidi i treguar në atë pozicion në sekuencën e përmendur SEQ ID NR: 1, ose ndonjë proteinë homologe e përftuar nga proteina në fjalë siç parashtrohet në SEQ ID NO: 1 me zëvendësim, shtim ose fshirje të të paktën një aminoacidi, me kusht që proteina e prejardhur të ruajë të paktën 70 % të identitetit me sekuencën e aminoacideve siç përcaktohet në SEQ ID NO: 1, dhe proteina e derivuar në fjalë që ruan aftësinë për të nxitur shkrirjen e membranës dhe ruan aftësinë për të bashkëvepruar me receptorin e membranës LDL, ku aminoacidi, i proteinës homologe në fjalë, i vendosur në një pozicion ekuivalent me pozicionin 47 ose me pozicionin 354, ose në të dy pozicionet 47 dhe 354 të sekuencës së përmendur SEQ ID NO: 1, është (janë) zëvendësuar nga një aminoacid i ndryshëm nga aminoacidi i treguar në atë pozicion në sekuencën SEQ ID N° 1, proteina e përmendur e izoluar jo-natyrore që ruan aftësinë për të nxitur shkrirjen e membranës dhe nuk është në gjendje të ndërveprojë me receptorin e membranës LDL.
2. Proteina e izoluar jo natyrale sipas pretendimit 1, ku proteina në fjalë përmban një nga sekuencat e mëposhtme të aminoacideve: - NR ID SEK: 15-20; - NR ID SEK: 21-26; - NR ID SEK: 45-50; dhe - NR ID SEK: 51-56.
3. Proteina e izoluar jo natyralisht sipas pretendimit 1 ose 2, ku aminoacidi në pozicionin 47 ose në pozicionin 354, ose në të dy pozicionet 47 dhe 354 janë zëvendësuar nga çdo aminoacid përveç K ose R, në veçanti nga A, G, F ose Q, mundësisht nga A ose Q.
4. Proteina e izoluar jo natyrale sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 3, që përfshin më tej një zëvendësim të aminoacidit në pozicionin 8 dhe/ose në pozicionin 209 nga ndonjë aminoacid i dallueshëm nga aminoacidi i treguar në atë pozicion në sekuencë N° ID SEK 1 ose në pozicionin ekuivalent në proteinën homologe në fjalë: ku aminoacidi në pozicionin 8 preferohet të zëvendësohet nga ndonjë aminoacid përveç H ose Q ose Y, dhe ku aminoacidi në pozicionin 209 preferohet të zëvendësohet nga ndonjë aminoacid përveç Y ose H.
5. Proteina e izoluar jo natyralisht sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 6, ku proteina në fjalë përbëhet nga një nga sekuencat e mëposhtme të aminoacideve NR ID SEK: 57-84 dhe 127-147.
6. Proteina e izoluar jo natyrale sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 5, që përfshin më tej një futje te një peptidi midis aminoacideve në pozicionet: 192 deri 202, ose 240 deri 257, ose 347 deri 353, ose 364 deri 366, ose 376 deri 379, ose 351 dhe 352; ose në pozicionin 1; peptidi i përmendur me origjinë nga një peptid i ndryshëm nga proteina siç parashtrohet në NR ID SEK: 1.
7. Proteina e izoluar jo natyrale sipas pretendimit 6, ku peptidi në fjalë është një ligand i një receptori qelizor, mundësisht një nanotrup, për shembull një nanotrup anti-HER2, një nanotrup anti-MUC18 ose një nanotrup anti-PD-1.
8. Një molekulë e acidit nukleik që kodon për një proteinë të izoluar jo natyrale siç përcaktohet në secilin nga pretendimet 1 deri në 7.
9. Një virus rekombinant që shpreh një proteinë të izoluar jo natyrale siç përcaktohet në secilin nga pretendimet 1 deri në 7.

10. Një virus rekombinant që përmban një molekulë të acidit nukleik siç përcaktohet në pretendimin 8.
11. Një qelizë eukariote që përmban ose shpreh një proteinë jo natyrale siç përcaktohet në secilin prej pretendimeve 1 deri në 7, ose që përmban një molekulë acidi nukleik siç përcaktohet në pretendimin 8, ose të infektuar nga një virus siç përcaktohet në pretendimin 9 ose 10.
12. Një përbërje që përfshin të paktën një nga këto: një proteinë sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 7; ose një molekulë e acidit nukleik siç përcaktohet në pretendimin 8, ose një virus sipas pretendimit 9 ose 10; ose, një qelizë eukariote sipas pretendimit 11; për përdorim si medikament.
13. Përbërja për përdorim sipas pretendimit 12, në trajtimin e kancerit.
14. Një përdorim in vitro i një proteine sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 7 për shënjestrimin e një membrane lipidike në një objektiv specifik, për shembull një qelizë, në veçanti një qelizë që do të vritet, si një qelizë kanceroze, ku proteina në fjalë është e ankoruar në lipidin në fjalë cipë.
15. Një proteinë sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 7, për përdorim në trajtimin e kancerit, ku proteina në fjalë është e ankoruar në një membranë lipidike dhe synon membranën lipidike të përmendur në një objektiv specifik, për shembull një qelizë, në veçanti një qelizë që do të vritet, siç është një qelizë kanceroze.

---

(11) **12428**
(97) EP3308671/ 29.05.2024
(96) 17183690.1/ 28.07.2017
(22) 10.07.2024
(21) AL/P/2024/394
(54) **FSHESË**
12.11.2024
(30) DE 102016114012 29/07/2016
(71) Joachim Huller/ Postfach 11 32, Reichenbergstrasse 3, 77716 Haslach / DE
(72) Joachim Huller/Postfach 11 32, Reichenbergstrasse 3, 77716 Haslach / DE, ,
(74) Krenar Loloçi
ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË
(EN) (54) **BROOM**
